



Himarë, më 01 .03 . 2024

**Lënda:** Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 22.02.2024.

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 22.02.2024 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1-Në anë të kësaj kërkesë kërkojmë të na vendoset në dispozicion vendimi për ndërtimin e ujësjellësit në lumin Shushicë.

-Bashkëngjitur vendimet:

2- Me anë të kësaj kërkesë për informacion kërkojmë një koment nga ana e Bashkisë Himarë, se përse ishte e nevojshme ndërtimi i ujësjellësit për Himarën në degen e Vjosës (lumin Shushicë)? Nuk ka Himara mundësi për të shfrytëzuar resurse të tjera ujore për realizimin e këtij ujësjellësi?

-Për sa i përket pyetjes së dytë ju informojmë se Fondi Shqiptar i Zhvillimit se bashku me Bashkinë Himarë dhe specialist të huaj nga KfW (Banka Gjermane) për një periudhë për më shumë se 2 vjet kanë bërë studime mbi prurjet e burimeve në të gjithë territorin e Bashkisë Himarë në burime të mundshme duke matur sasinë e prurjeve në të gjithë muajt e vitit për të konstatuar kapacitetin dhe potencialin e tyre.

Si pasojë e këtij studimi është parë që në afërsi të bregdetit nuk është vërejtur asnjë burim i cili do të plotësonte kapacitetin e prurjeve apo të cilësisë së ujit të pijëshëm. Ato pak burime që gjenden në këtë zonë kanë një prurje të vogël sezonale dhe një pjesë të mirë të vitit janë të tharë. Gjatë këtij studimi i vetmi burim i cili plotëson kushtet e prurjes dhe cilesisë së ujit ishte burimi i Lepushës përgjatë rrjedhjes së lumit të Shushicës. Ky burim nuk është i vetmi burim në këtë lume por lumi i Shushicës ka disa dhjetra burime të tjera të cilët furnizojnë në mënyrë të shëndetshme këtë lum dhe duke konsideruar që nga prurja kryesore e burimit të Lepushës shfrytëzohet vetëm një pjesë e tij mund të themi që u bazuar në llogaritjet e shfrytëzimit pjesërisht i këtij burimi do të ndikonte në mënyrë të papërfillshme në jetën e lumit.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!